



# Shkrimi i projekt propozimeve

23.09.2021

Autor: Ardian Haxhaj

PACT (Partners in Action)



# Pojekt-propozimi - një definicion i shkurtër

- ▶ Çdo ide kërkon disa hapa paraprakë që çon në realizimin e saj;
- ▶ Çdo process për realizimin e një ideje, apo më shumë, kërkon hartimin ose shkrimin e projekt-propozimeve, në të cilin sqarohet rëndësia e realizimit të projektit;
- ▶ Nuk ka realizim të projektit pa projekt-propozim;
- ▶ Projekt-propozimi është një formë e veçantë e kërkesës me shkrim përmes së cilës kërkohet mbështetje nga një fondacion, organizatë ndërkombëtare, institucion qeveritar, ndërqeveritar, etj., për financimin e projektit me qëllim të zbatimit të tij;
- ▶ Në fillim ishte fjala...

# Mbledhja e informatave

- ▶ Realizimi i një projekti kërkon mbledhje të informative për problemin dhe mundësitë e financimit;
- ▶ Projekti duhet të korrespondojë me politikat e financimit të donatorëve;
- ▶ Projekt-propozimi të shkruhet sa më konciz dhe relevant.

# Fazat e projekt-propozimeve

- Pjesa më e madhe e informacioneve të kërkuara për të shkruar një projekt-propozim mblidhen gjatë fazës së identifikimit:
  - 1) konteksti i projektit;
  - 2) problemi që kërkon trajtim;
  - 3) Analiza socio-ekonomike;
  - 4) Prioritetet e palëve të interesuara;
  - 5) Përshkrimi i situatës;
  - 6) Arsyeshmëria e projektit;
  - 7) Përshkrimi i situatës;
  - 8) Përshkrimi i përfituesve dhe palëve të interesuara.

# Pse projekt-propozimi është i rëndësishëm?

- ▶ Projekt-propozimi është bazë për vendimmarrje nga ana e donatorit, nëse financohet projekti apo jo;
- ▶ Pas pranimit të projekt-propozimit nga donatori, njëherit projekt-propozimi shërben edhe si kornizë e projektit për hapat e mëtejshëm të implementimit të projektit;
- ▶ Shkrimi adekuat dhe profesional i projekt-propozimit është traseja më e mirë e suksesit të tij gjatë realizimit.

# Suksesi i OJQ-ve në gjetjen e fondeve financiare

- ▶ Primare: sa më shumë që bazohet projekt-propozimi në nevoja të komunitetit, aq më shumë ka gjasa për mundësi financimi nga donatorët;
- ▶ Të përcaktohet qartazi në projekt-propozim vizioni, misioni dhe qëllimi i organizatës në relacion me projektin e propozuar për donatorët;
- ▶ OJQ-të nuk duhet të kërkojnë financim për zbatimin e projekteve që janë jashtë sferës së misionit, misionit dhe qëllimeve të organizatës.

# Përgatitja për shkrimin e projekt-propozimit

- ▶ Hulumtimi: mbledhja adekuate dhe profesionale e informative për çështjen që duhet trajtuar;
- ▶ Mbledhja e informatave e mundëson definimin e qartë të idesë së projektit;
- ▶ Nëse problemi kuptohet plotësisht dhe indentifikohen mundësitë për zgjidhje, atëherë realizimi është më i lehtë;
- ▶ Një përshkrim i përgjithshëm i gjendjes së një problemi, mundësisht edhe për shkaqet e gjendjes;
- ▶ Të dhëna statistikore që e konkretizojnë projekt-propozimin, të cilat e arsyetojnë qëllimin e realizimit të projektit.

# Disa hapa paraprakë 1

- ▶ Të sigurojë mbështetjen e komunitetit lokal: donatorët janë të interesuar që në projektet që i financojnë të jenë të përfshirë komunitetet mbi të cilat targetohet projekt-propozimi;
- ▶ Të takojë dhe të merr në konsideratë opinionin e ekspertëve të fushës: kjo mund të jetë shumë e dobishme në përpunimin e ideve dhe e ngrit besueshmërinë e projektit;
- ▶ Të lokalizojë mundësitë për financim: duhet të identifikohen programet, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet qeveritare që e mbështesin sektorin përkatës dhe projektet e ngjashme.



# Disa hapa paraprakë 2

- Sigurohuni në mbledhjen e informative për financuesin/donatorin në lidhje me:
  - a) Donatorët të cilëve do t'ju drejtoheni;
  - b) Sektorët prioritarë që donatorët i mbështesin;
  - c) Ndonjë dokument strategjik të donatorit (nëse ekziston ndonjë i tillë);
  - d) Procedurat e tyre për selektimin dhe vlerësimin e aplikimeve;
  - e) Udhëzuesit për përgatitjen e projekt-propozimeve;
  - f) Kërkoni informatat e duhura në internet, në udhëzimet për donatorë, në raportet vjetore etj.

# Shkrimi i koncept-dokumentit të projektit

- ▶ Shumë donatorë së pari e kërkojnë koncept-dokumentin e projektit para projekt-propozimit të plotë;
- ▶ Koncept-dokumenti është një përmbledhje e shkurtër e projektit që duhet të konceptohet para dërgimit të projektit të plotë (nëse paraprakisht kërkohet nga donatorit);
- ▶ Koncept-dokumenti i projektit mund të jetë i strukturuar, duke përmbledhur informata të hollësishme rreth projektit, por që përgjithësisht Koncept-dokumenti e ka kuptimin e një pasqyre të idesë së projektit.

# Shembull i koncept-dokumentit

- ❖ Përshkrimi projektit: qëllimi, objektivat, rezultatet, aktivitetet, grupi i synuar/përfituesit;
- ❖ Rëndësia e projektit: ndërlidhja me problemin që projekti synon të adresojë;
- ❖ Përshkrimin për grupin e synuar të projektit: përcaktimi i grupit të synuar dhe përfituesve, nevojat dhe problemet e tyre, veprimet që do të ndërmerren për adresimin e nevojave;
- ❖ Qëndrueshmërinë e projektit: si do të vazhdojë ndikimi i projektit pas përfundimit të projektit?
- ❖ Buxhetin: shpenzimet e projektit.

# Vëmendje!

- ▶ Koncept-dokumenti është një nga hapat më të rëndësishëm gjatë aplikimit;
- ▶ Pas kontrollit administrativ, si hap i parë në procesin e vlerësimit vlerësohet koncept-dokumenti dhe vetëm nëse ai i merr pikët minimale bazuar në kriteret e kërkuara dhe që konsiderohet relevant, atëherë aplikuesit do t'i kërkohet të dorëzojë një projekt-propozim të plotë.

# Fillimi i hartimit të projekt-propozimit

- ▶ Pas fazës së identifikimit të idesë së projektit, duhet të dizajnohet projekti dhe të planifikohen fazat e implementimit.
- ▶ Gjatë shkrimit të projekt-propozimit duhet të kryhen analiza që të konfirmohet:
  - ✓ Arsyeshmëria e projektit;
  - ✓ Rëndësia e projektit;
  - ✓ Realizueshmëria e projektit.

# Funksionet e projekt-propozimit

- ▶ E përshkruan një problem (donatorët nuk japin para pa ndonjë arsye të mbështetur me fakte, apo që i adreson në thelb nevojat e komunitetit) që do ta adresojë projekti;
- ▶ E përshkruan një zgjidhje për problemin: propozimi duhet ta përshkruajë zgjidhjen e mundshme që zbatimi i projektit do të sjellë dhe pse kjo zgjidhje ka gjasa të funksionojë;
- ▶ Është një plan: që përshkruan hap pas hapi atë së cfarë planifikohet të bëhet gjatë cdo faze të projektit;
- ▶ Është një kërkesë: që përdoret për ta bindur financuesin për ta financuar projektin dhe për të krijuar besim se aplikanti do t'i përdorë fondet në mënyrë të duhur për ta përfunduar projektin;
- ▶ Është një premtim dhe zotim: se aplikanti do ta adresojë problemin dhe do të angazhohet në zbatimin e planit, ashtu siç është propozuar.

# Vëmendje!

- ▶ Projekt-propozimi duhet të jetë i lehtë për t'u lexuar, pa gabime ortografike dhe me dizajn korrekt;
- ▶ Projekt-propozimi të shkruhet me gjuhë të qartë;
- ▶ Çdo shqyrtim i projekt-propozimit duhet të mbështetet me fakte dhe analiza adekuate;
- ▶ Të modifikohet projekt-propozimi me kriteret e paraqitura nga donatori në thirrjen për aplikim.

# Përgjigjet që duhet t'i ketë një projekt-propozim

- ▶ Cili është problemi, apo nevoja për zgjidhje;
- ▶ Përse problemi është i rëndësishëm dhe urgjent;
- ▶ Cilat janë qëllimet dhe objektivat e projektit;
- ▶ Cilat metoda do t'i përdorni për t'i arritur këto qëllime;
- ▶ Përse i keni zgjedhur këto metoda;
- ▶ Përse keni gjasa të arrini sukses;
- ▶ Cilat janë planet operacionale;
- ▶ A e keni hartuar buxhetin real dhe të saktë;
- ▶ Cila është struktura e financimit të projektit.



# Struktura e përgjithshme e një projekt-propozimi

SEKSIONI	PËRMBAJTJA	SHËNIMI
Ballina/Informatat e përgjithshme	<ul style="list-style-type: none"><li>➤ Titulli i projekt propozimit;</li><li>➤ Emri i organizatës të cilës i dërgohet projekt-propozimi;</li><li>➤ Emri, adresa dhe logoja e organizatës;</li><li>➤ Emri dhe adresa e personit kontaktues nga organizata.</li></ul>	Titulli duhet të prezantojë thelbin e projektit në një fjali të shkurtër.
Përmbledhja	<p>Prezantoni esencën e projektit, duke paraqitur shkurtimisht:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Çfarë është situata aktuale;</li><li>➤ Mënyra për të adresuar problemet;</li><li>➤ Cfarë ndikimi do të arrihet;</li><li>➤ Cilët do të jenë përfituesit kryesorë;</li><li>➤ Cilat janë shpenzimet e projektit</li></ul>	Përmbledhja e propozimit orientimisht rreth një faqe.

# Projekt-propozimi i detajuar

## Faqja e titullit të projektit

- ❑ Titulli i projekt-propozimit e përcakton projektin në mënyrë përmblledhëse dhe shkurtimisht;
- ❑ Titulli e pasqyron krejt projektin;
- ❑ Titulli i projektit mund të jetë edhe një fjali e shkurtër që asocion me përmbajtjen e projektit.

# Përmbledhja e projekt-propozimit

- ▶ Përmbledhja e projekt-propozimit shkruhet pasi të përfundojnë të gjitha pjesët e tjera të projekt-propozimit;
- ▶ Përmbledhja vendoset në fillim të projekt-propozimit;
- ▶ Përmbledhja e projekt-propozimit i përmban të gjitha elementet e projektit, siç janë:
  - Nevoja-problemi brenda komunitetit;
  - Arsyet dhe rëndësia e projektit për komunitetin;
  - Qëllimi dhe objektivat e projektit;
  - Grupi i synuar;
  - Përfitimet e komunitetit nga aktivitetet e propozuara.

# Informacion për organizatën aplikuese dhe partnerët

- ❑ Përshkrimi i profilit të organizatës;
- ❑ Kualifikimet dhe përvoja e oganizatës:
  - Informata të përgjithshme (emri i organizatës, adresa, të dhënat e bankës etj.);
  - Historiku i organizatës (duke e përfshirë vitin e themelimit);
  - Vizioni dhe misioni;
  - Qëllimi, objektivat dhe strategjitë;
  - Arritjet;
  - Projektet e tanishme;
  - Përvojat në realizimin e projekteve të ngjashme;
  - Bashkëpunimin me donatorë;
  - Strukturën e menaxhimit të organizatës;
  - Buxhetin vjetor;
  - Vlerën financiare dhe hapësirat e organizatës.

# Arsyeshmëria e projektit

## Problemi

- një analizë e shkurtër e situatës dhe e rëndësisë së problemit që përpiqeni ta zgjidhni;
- Shpjegues të qartë statistikorë;
- Dokumentimi i problemit;
- Konkluzioni se problem ekziston në të vërtetë;
- Informacione të vlefshme dhe të besueshme;
- Raporte zyrtare, botime, artikuj kërkimorë të gazetave etj.

# Prioritetet

- ▶ Në çfarë mënyre ndërlidhet projekti me një ose më shumë prioritete të thirrjes publike për aplikim, apo me prioritetet dhe objektivat e dokumenteve të ndryshme strategjike, siç janë strategjitë kombëtare, qeveritare, lokale etj.;
- ▶ Pse është i nevojshëm realizimi i projektit tuaj;
- ▶ Kush përfiton nga realizimi i projektit;
- ▶ Si do të ndikojë projekti te grupi/grupet e synuara etj.

# Përshkrimi i detajuar i projektit 1

- ▶ Metodatat që do të përdoren dhe arsyetimi për një metodologji të tillë;
- ▶ Si do ta përmirësojnë situatën e grupeve të synuara rezultatet e projektit;
- ▶ Identifikoni dhe përshkruani në detaje çdo aktivitet që do ta ndërmerri për t'i arritur rezultatet dhe specifikoni rolin e secilit partner në realizimin e aktiviteteteve;
- ▶ Struktura organizative dhe ekipi i propozuar për zbatimin e projektit sipas funksionit;
- ▶ Procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

# Përshkrimi i detajuar i projektit 2

## Grupi i synuar

- ▶ Cili është grupi i synuar dhe cilat janë nevojat e tij;
- ▶ Kush do të përfitojë nga projekti dhe në çfarë shkalle do të ndikohen përfituesit e projektit;
- ▶ Cilët janë treguesit e saktë të përfitimit nga ana e grupit të synuar;
- ▶ Cili është mendimi i grupit të synuar për projektin;
- ▶ Si ndikohet grupi i synuar nga projekti.



# Qëllimi i përgjithshëm i projektit

- ▶ Të përshkruhet qëllimi i projektit që duhet të jetë i ndërlidhur ngusht me grupin e synuar dhe t'i përgjigjet sfidave të grupit të synuar;
- ▶ Qëllimi i përgjithshëm e shpjegon ndikimin e projektit në eleminimin, zvogëlimin, apo përmirësimin e problemit ekzistues;
- ▶ Projekti duhet t'i përmbushë politikat e përgjithshme dhe prioritetet e qeverisë qendrore, lokale, si dhe politikat e financuesit.

# Objektivat specifike të projektit

- ▶ Më së shumti tri objektiva specifike (të konkretizuara në detaje dhe të qartësuara);
- ▶ Objektiva që janë të realizueshme;
- ▶ Objektiva që interferojnë në cdo mënyrë me zgjidhjen e problemeve të grupit të synuar.

# Katër elementet bazike të shpjegimit të objektivave

- ▶ Cila: natyra e situatës që duhet ndryshuar;
- ▶ Kush: grupi i synuar;
- ▶ Sa: një analizë e situatës që më vonë mund të përdoret si bazë për vlerëzimin e arritjes së objektivave;
- ▶ Kur: data e planifikuar për arritjen e objektivave.

# Sugjerime për shkrimin e objektivave

- ▶ Shkruani një përshkrim bindës të objektivave të projektit dhe se si do të kontribuojnë ato në qëllimin e përgjithshëm të projektit;
- ▶ Së pari objektivat (të mos ngatërrohen me aktivitetet);
- ▶ Arritja e objektivave të projektit tregon edhe rezultatin final të projektit;
- ▶ Arritjet e objektivave duhet të jenë reale.

# Sugjerime për shkrimin e rezultateve

- ▶ Ndërlidhni rezultatet me shkaqet e problemit kryesor që përballet grupi i synuar i projektit;
- ▶ Paraqitni arritjet e rezultateve në eleminimin e problemit;
- ▶ Paraqitni përfitimet e grupit të synuar;
- ▶ Rezultatet të jenë të matshme, specifike dhe të përcaktuara në kohë.

# Aktivitetet e projektit

- ❑ Për realizimin e objektivave dhe rezultateve nevojiten një seri e aktiviteteve - termi “aktivitet” i referohet një detyre specifike;
  
- ❑ Përshkrimi i aktiviteteve:
  - Çfarë do të ndërmerret;
  - Kush janë përfituesit;
  - Kush do të përfshihet në projekt dhe kush do të pëfitojë;
  - Kur do të ndodhë aktiviteti dhe ku;
  - Kush do ta kryej aktivitetin;
  - A do të bashkëpunojë organizata juaj me organizata të tjera për ta kryer aktivitetin;
  - Cilat materiale, ose burime do të përdoren për ta kryer aktivitetin.

# Rreziqet e mundshme të projektit

- ▶ Çdo projekt mund t'i ketë edhe rreziqet e mosfunksionimit, apo pamundësisë për implementim;
- ▶ Rreziqet janë formulime negative për ngjarjet e padëshiruara që mundën të ndodhin gjatë zbatimit të projektit;
- ▶ Zakonisht rreziqet gjatë realizimit të projektit janë si rezultat i faktorëve të jashtëm;
- ▶ Rëndësia e identifikimit të rreziqeve paraprake të projektit mundëson parapërgatitjet për tejkalimin e tyre.

# Monitorimi i projektit

- ▶ Monitorimi mundëson kontrollimin e vazhdueshëm të aktiviteteve dhe ndihmon në rishikimin e progresit të bërë hap pas hapi;
- ▶ Përmendja e pjesës së monitorimit e bën të besueshëm projekt-propozimin para donatorit;
- ▶ Siguron të dhëna se çfarë shkon mirë në projekt, ose ku paraqiten vështirësitë;
- ▶ Mundëson përmirësimin e ngecjeve, parregullsive etj.;
- ▶ Monitorimi bëhet gjatë secilës fazë të projektit, ku njëherit shërben edhe për prezantimin e rezultateve të projektit;
- ▶ Monitorimi shërben edhe për menaxhimin adekuat të kohës dhe buxhetit.



# Hartimi i buxhetit: tri elementet përmbajtësore

- ▶ Përmbledhja e buxhetit;
- ▶ Buxheti i detajuar në seksione;
- ▶ Shënime mbi buxhetin (arsyeshmëria).

# Hartimi i buxhetit në projekt-propozim

- ▶ Buxheti duhet të përfshijë planin financiar për implementimin e projektit;
- ▶ Vetëkontributin e organizatës;
- ▶ Kontributin e përfituesve;
- ▶ Fondet e siguruar nga donatorët e tjerë (nëse ka);
- ▶ Të përfshihen të gjitha shpenzimet e projektit, si dhe shpenzimet anësore: shpenzimet e zyres, shpenzimet administrative, të punëtorëve etj.

Pyetje... diskutime... konkluzione...

